



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
- Kuvendi i Komunës-
01Nr. 16- 24604/12
Kaçanik, 27.09.2012

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisje Lokale, të nenin 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27.09.2012, mori këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E MINI
HIDROCENTRALEVE MBI LUMIN LEPENC

I.

Me këtë Vendim, bëhet caktimi i lokacionit për ndërtimin e Mini Hidrocentraleve mbi lumin Lepenc, dhe atë: në pjesën e parcelës kadastrale nr. 1398, me sipërfaqe prej 0.35.15 ha, shënuar sipas Çertifikatës nr. 242, Z.K Soponicë, pj. e parc. Kat.nr.5, me sipërfaqe prej 0.24.03 ha, e shënuar sipas Çertifikatës nr. 86, Z.K. Kaçanik, dhe pjesa e parcelës kat. nr. 780, me sipërfaqe prej 0.05.20 ha, e shënuar sipas Çertifikatës nr. 65, Zona Kadastrale Nikaj dhe pjesa e parc.kat.nr. 965, me sipërfaqe prej 0.20.46 ha, shënuar sipas Çertifikatës nr. 122-Ujërat, Z.K Nikaj.

II.

Pasuria e paluajtshme e përshkruar nën pikën I-r (parë) të këtij vendimi do të shërbej për ndërtimin e Mini Hidrocentraleve dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera.

III.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes nga kuvendi i komunës.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

V.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Xhelal Gashi